



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr. 587/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik, Opre Roma Kosova me seli në Graçanicë, të paraqitur kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive lidhur me numërimin e votave për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 14.02.2025, merr këtë:

## V E N D I M

Hedhet e palejuar ankesa A.nr.587/2025, e datës 14.02.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik, Opre Roma Kosova, me seli në Graçanicë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive lidhur me numërimin e votave për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 09 Shkurt 2025.

## A r s y e t i m

PZAP-i më datë 14.02.2025, ka pranuar ankesën Anr.587/2025, nga Subjekti Politik Opre Roma Kosova me seli në Graçanicë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive lidhur me numërimin e votave. Në ankesë pretendohet se sipas të dhënave të mëparshme subjekti politik Opre Roma Kosova ka marrë gjithsej 501 vota, ndërsa pas verifikimit të fundit, ky numër është ulur në 435 vota, andaj kjo ulje e konsiderueshme e votave ka ngritur dyshime për saktësinë e procesit të numërimit të votave. Më tutje në ankesë pretendojnë se në Komunën e Pejës numri i votave ka qenë 91 për subjektin në fjalë, ndërsa tash janë 28 vota dhe se ky rezultat ka të bëjë vetëm për një komunë, dhe se kanë dyshime se parregullsi të tjera mund të ketë edhe ne komuna tjera. Andaj ne ankesë pretendojnë për një rinumërim të votave për të siguruar që procesi është kryer sipas ligjit dhe rregullave të përcaktuara, si dhe për të shmangur çdo dyshim për manipulim të mundshëm.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur fotografi që tregon ndryshimin e numrit të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak te ankesës, vëren se ankesa është e palejuar.

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive lidhur me numërimin e votave, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultati i cili ende nuk është shpallur si rezultat preliminar nga KQZ, e i cili rezultat mund të ndryshoj, dhe se ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor, faza e procesit zgjedhor kur parashtrrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.3 të Ligji Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Bazuar në arsyet e dhëna më lart, dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, i cili përcakton se *“PZAP-ja, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”*, dhe nenit 13.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se *“PZAP, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesës si të palejueshme nuk e paragjykon rezultatin përfundimtar, e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore pala mund ta atakoj rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, dhe 13.3 Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
A nr.587/2025 datë 14.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.